

Dokument praktike

PARAQITJA GRAFIKE E DISENJOVE
INDUSTRIALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI) E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Shënim për Zyrën e Pronësisë Intelektuale:

Ky Dokument praktike është përgatitur në përputhje me Komunikimet e Përbashkëta që rezultojnë nga Praktika e Përbashkët e Disenjove Industriale të zhvilluara nga Rrjeti i Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPN) dhe që synojnë të japin udhëzime për procedurat e ekzaminimit rreth mënyrës së përdorimit të përjashtimeve të duhura nga mbrojtja, llojet të pamjeve dhe mënyrës së paraqitjes së disenjove industriale në sfond neutral. Ky dokument është përshtatur sipas specifikave të Shqipërisë dhe, do të sigurojë një përmbledhje të standardeve të cilësisë së Zyrës për aplikimet e disenjove industriale të marra në rrugë elektronike dhe me letër.

Ky Dokument praktike, i miratuar në nivel kombëtar, mund të bëhet publik me qëllimin e rritjes së mëtejshme të transparencës, sigurisë ligjore dhe parashikueshmërisë në dobi si të ekzaminuesve, ashtu dhe të përdoruesve.

1. INFORMACION

Ky dokument do të jetë referencë për aplikantët, Shoqatat e Përdoruesve dhe përfaqësuesit mbi praktikën e kërkesave për paraqitjen grafike të disenjove industriale. Këto kërkesa mbulojnë përdorimin e përjashtimeve vizuale nga mbrojtja, përdorimin e llojeve të ndryshme të pamjeve dhe mënyrën e riprodhimit të një disenjeje industriale me një sfond neutral. Për më tepër, ky dokument gjithashtu ofron rekomandime për të rritur kuptimin e aplikantëve se si të riprodhojnë më mirë disenjot e tyre dhe standardet e cilësisë së Zyrës për aplikimet për disenjot industriale të marra me mjete elektronike dhe me letër.

Udhëzimi i mëposhtëm lidhet vetëm me procedurat e ekzaminimit dhe nuk ka për qëllim të japë këshilla mbi objektivin e mbrojtjes së një disenjeje industriale sipas ligjit kombëtar.

Çështjet e mëposhtme janë jashtë objektivit:

- Përjashtimet verbale nga mbrojtja
- Elementet shtesë
- Prioriteti
- Zbulimi i informacionit
- Numri i pamjeve
- Paraqitjet e animuara me kompjuter, paraqitjet 3D



2. PRAKTIKA


Teksti i mëposhtëm përmbledh mesazhet kyçe dhe deklaratat kryesore të parimeve të Praktikës. Teksti i plotë dhe të gjithë shembujt e përdorur për të ilustruar kriteret mund të gjenden në pjesën vijuese të dokumentit, duke përfshirë standardet e cilësisë të kërkuara për aplikimet e marra me mjete elektronike dhe me letër.

Imazhet duhet të jenë të një cilësie të mirë dhe në gjendje për riprodhim. Për të përcaktuar kërkesat për një paraqitje të saktë grafike të disenjove industriale, merren parasysh kriteret e mëposhtme:

2.1 NË LIDHJE ME PËRDORIMIN E PËRJASHTIMEVE VIZUALE NGA MBROJTJA







Përkufizimi	Përfjashtimet vizuale nga mbrojtja tregojnë se nuk kërkohet mbrojtja dhe se nuk është dhënë regjistrimi për karakteristika të caktuara të disnejos industriale të shfaqura në paraqitje. Kështu, ato tregojnë atë që nuk synohet të mbrohet.
Kërkesat	Përfjashtimet vizuale nga mbrojtja do të pranohen vetëm kur: • Ato tregojnë qartë se nuk kërkohet mbrojtja për karakteristika të caktuara të disnejos industriale të treguar në paraqitje. • Ato shfaqen vazhdimisht në të gjitha pamjet ku shfaqet përfjashtim nga mbrojtja. RCD Nr. 002322644-0001 (07.02) (dorezat e tiganëve) Pronari: ACTERVIS, GMBH
Rekomandimet/ Udhëzimet	Preferohen paraqitjet grafike ose fotografike që tregojnë vetëm disenjon industriale të pretenduar. Megjithatë, mund të përdoren përfjashtime nga mbrojtja kur paraqitja grafike ose fotografike e disnejos industriale përmban pjesë të produktit për të cilat nuk kërkohet mbrojtje. Në këto raste, përfjashtimi nga mbrojtja duhet të jetë i qartë dhe i dallueshëm: karakteristikat e pretenduara dhe të përfjashtuara nga mbrojtja duhet të diferencohen qartë. Kur përdoret një përfjashtim nga mbrojtja, rekomandohen vijat e ndërprera. Vetëm kur vijat e ndërprera nuk mund të përdoren për arsye teknike (për shembull, kur ato përdoren për të treguar qepjen e veshjeve ose motivet; ose kur përdoren fotografitë), mund të përdoren përfjashtimet e tjera nga mbrojtja: hijezimi me ngjyra, bordura dhe sfumimi.

a) Vijat e ndërprera	Nëse përdoret një përjashtim nga mbrojtja, rekomandohen vijat e ndërprera. Ato përdoren për të treguar se nuk kërkohet mbrojtje për karakteristikat që shfaqen duke përdorur gjurmën e ndërprerë. Për t'u pranuar, karakteristikat për të cilat nuk kërkohet mbrojtje duhet të tregohen qartë me vija të ndërprera, ndërsa pjesët për të cilat kërkohet mbrojtje duhet të tregohen me vija të vazhdueshme.  Diseno industriale BX e regjistruar nr. 38212-0001 (12.16) (pasqyrat e pasme) Pronari: Interimage BV  Diseno industriale hungareze e regjistruar nr. D9900409-0001 (08.04) (doreza e kaçavidës) Pronari: Cooper Industries, Inc. Kur vijat e ndërprera janë një karakteristikë e disenjos industriale dhe një pjesë e disenjos industriale duhet të përjashtohet nga mbrojtja, mund të përdoren përjashtime vizuale të tjera nga mbrojtja.
b) Hijezimi me ngjyra	Edhe pse vijat e ndërprera janë përjashtimi nga mbrojtja i preferuar, nëse nuk mund të përdoren, përdorimi i hijezimit me ngjyra mund të jetë një opsion. Ky lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja konsiston në përdorimin e toneve kontrastuese të ngjyrave për të errësuar mjaftueshëm karakteristikat për të cilat nuk kërkohet mbrojtja. Karakteristikat për të cilat kërkohet mbrojtja duhet të tregohen qartë në mënyrë që ato të jenë qartësisht të perceptueshme, ndërsa karakteristikat e përjashtuara nga mbrojtja duhet të paraqiten me një tonalitet të ndryshëm ngjyre dhe në mënyrë të tillë që ato të shfaqen të turbulluara ose të papërceptueshme.  RCD nr.. 000910146-0004 (12.08) (Pjesë automobili) Pronari: TOYOTA MOTOR CORPORATION


c) Bordurat	Edhe pse vijat e ndërprera janë përjashtimi nga mbrojtja i preferuar, nëse nuk mund të përdoren, përdorimi i bordurave mund të jetë një opsion. Me këtë lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja, karakteristikat për të cilat kërkohet mbrojtje duhet të tregohen/paraqiten qartë brenda bordurës, ndërsa të gjitha karakteristikat jashtë bordurës konsiderohen të jenë të përjashtuara nga mbrojtja dhe për këtë arsye nuk mbrohen. Bordurat duhet të përdoren me kujdes në vizatimet/fotografitë për shkak të rrezikut për të përfshirë më shumë se vetëm disenjon industriale brenda bordurës.     RCD Nr. 001873688-0003 (02.04) (shuall këpuce) Pronari: Mjartan s.r.o. CP6 Shembull (12.16) (Grila për hyrjen e ajrit për automjete)
d) Sfumimi	Edhe pse vijat e ndërprera janë përjashtim nga mbrojtja i preferuar, nëse nuk mund të përdoren, përdorimi i sfumimit mund të jetë një opsion. Ky lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja konsiston në sfumimin e karakteristikave për të cilat nuk kërkohet mbrojtja dhe mund të pranohet vetëm kur karakteristikat për të cilat kërkohet mbrojtje dallohen qartë nga karakteristikat e e përjashtuara nga mbrojtja (të sfumuar).   RCD Nr. 000244520-0002 (12.15) (Goma për rrota automjetesh, pneumatike) Pronari: Nokian Tyres plc

2.2 NË LIDHJE ME LLOJET E NDRYSHME TË PAMJEVE


Përkufizimi	Një pamje është një paraqitje vizuale e disenjos industriale. Ajo mund të paraqesë disenjon industriale nga drejtime (kënde) të ndryshme ose në momente të ndryshme në kohë ose në gjendje të ndryshme.
Rekomandime të përgjithshme	- Në shumicën e rasteve, pamjet e aspekteve (shiko udhëzimet më poshtë) janë të mjaftueshme për të zbuluar të gjitha karakteristikat e disenjos industriale. Sidoqoftë, aplikanti mund të japë pamje plotësuese/shtesë në mënyrë që të zbulojë më tej karakteristikat e disenjos industriale (në varësi të numrit maksimal të pamjeve të lejuara nga secila Zyrë). - Nuk është e detyrueshme që aplikanti të depozitojë një numër të caktuar pamjesh ose një lloj pamjeje të caktuar, për sa kohë që të gjitha karakteristikat e disenjos industriale mund të perceptohen qartë, p.sh. një pamje mund të jetë e mjaftueshme. - Pamjet duhet t'i përkasin të njëjtit disenjo industriale dhe secila pamje duhet të tregohet më vete. - Në rastin e produkteve të përbëra nga disa pjesë, të paktën një pamje duhet të paraqesë të gjithë produktin.
Udhëzime për secilën lloj pamjeje:	Preferohet përdorimi i pamjeve të aspekteve për të treguar karakteristikat e disenjos industriale. Sidoqoftë, aplikanti është i lirë të sigurojë pamje plotësuese/shtesë siç u përmend më lart. Prandaj:
a) Pamjet e aspekteve	Tregojnë disenjon industriale nga drejtime (kënde) të caktuara dhe përfshijnë pamjet e mëposhtme: pamjen e përparme, pamjen e sipërme, pamjen e poshtme, pamjen e anës së djathtë, pamjen e anës së majtë, pamjen e pasme dhe pamjet në perspektivë. Aplikanti rekomandohet të paraqesë sa më shumë pamje të jetë e nevojshme për të treguar plotësisht karakteristikat e disenjos industriale. Në disa raste, një pamje mund të jetë e mjaftueshme.   RCD Nr. 002325456-0001 (31.00) (Mikserë, elektrikë [kuzhinë]) Pronari: KENWOOD LIMITED
b) Pamje që zmadhojnë një pjesë të disenjove industriale	Tregojnë një pjesë të disenjos industriale të përgjithshme në një shkallë të zgjeruar. Një pamje e vetme e zmadhuar është e pranueshme me kusht që pjesa e zmadhuar të jetë tashmë e dukshme në njërin nga pamjet e tjera të depozituara dhe paraqitet në një pamje të vetme të veçantë.



	   RCD Nr. 001913690-0002 (24.02) (Pllaka PCR me shumë fole) Pronari: ABGENE LIMITED
c) Pozicionet alternative	Disenjt Industrialë me pozicione alternative kanë një pamje e cila mund të modifikohet në disa konfigurime pa ndonjë shtesë ose heqje të ndonjë pjese. Pamjet që tregojnë konfigurimet e ndryshme të disenjos industriale duhet të tregohen të veçuara.    RCD Nr. 000588694-0012 (14.03) (Telefona celulare) Pronari: Fujitsu Mobile Communications Limited
d) Pamjet e çmontuara	Pamjet ku pjesët e një produkti shfaqen të çmontuara për të sqaruar sesi pjesët përshtaten së bashku. Këto pamje duhet të kombinohen me të paktën një pamje që paraqet produktin e montuar. Të gjitha pjesët e një produkti duhet të tregohen të çmontuara në një pamje të veçantë të vetme, në afërsi dhe sipas rendit të montimit.    Disenjo industriale kroate e regjistruar Nr. D20140080 (24.01) (Byzlykë me stimulues për muskujt) Pronari: Dominik Žinić Shënim: Shfaqja e pjesëve të çmontuara në një pamje shtesë mund të ndihmojë në lehtësimin e të kuptuarit të disenjos industriale. Sidoqoftë, mbrohen vetëm pjesët që mbeten të dukshme gjatë përdorimit normal të produktit.
e) Pamjet e pjesshme	Tregojnë një pjesë të një produkti të izoluar. Pamjet e pjesshme mund të zmadhohen dhe duhet të kombinohen me të paktën një pamje që paraqet produktin e montuar.     

	RCD Nr. 2038216-0001 (15.01, 23.04) (Filtrat e ajrit, Kontejnerët për filtra ajri, për motorë) Pronar: BMC S.r.l.
f) Pamjet e prerjeve të tërthorta	Pjesët e prera që plotësojnë pamjet e aspekteve duke ilustruar një karakteristikë ose karakteristikat e pamjes së produktit, siç është konturi, sipërfaqja, forma ose konfigurimi i produktit. Pamjet e prerjeve të tërthorta duhet, në mënyrë të qartë, të jenë një pamje e të njëjtit diseno industriale dhe duhet të dërgohen me pamje të tjera tradicionale, siç janë pamjet e aspekteve. Duhet të theksohet se nuk lejohen paraqitjet me indikacionet teknike të tilla si linjat aksiale ose madhësitë (dimensionet) ose numrat. Diseno industriale spanjolle e regjistruar Nr. I0152702-D (01.01) (biskota) Pronari: CUETARA, S.L. Shënim: Shtimi i pamjeve të prerjeve të tërthorta mund të ndihmojë në lehtësimin e të kuptuarit të disenjos industriale. Sidoqoftë, mbrohen vetëm pjesët që mbeten të dukshme gjatë përdorimit normal të produktit.
g) Sekuencë pamjesh të shkrepura (diseno industriale të animuara)	Sekuencat e shkurtër e pamjeve të përdorura për të treguar një diseno industriale të vetme të animuar në momente të ndryshme specifike në kohë, në një progres të qartë dhe të kuptueshëm. Kjo vlen për një ikonë të animuar (diseno industriale e përbërë nga një sekuençë) ose një ndërfaqe grafike e animuar e përdoruesit (diseno industriale e një ndërfaqeje). Për t'u pranuar: Sekuencat e shkrepjeve fotografike duhet të lidhet vizualisht (duhet të ketë karakteristika të përbashkëta) dhe është përgjegjësi e aplikantit t'u vendosë numra pamjeve në mënyrë të tillë që të japë një perceptim të qartë të lëvizjes/progresit. RCD Nr 2085894-0014 (14.04) (Pamje ekrani të animuara) Pronari: NIKE Innovate C.V.

h) Kombinimi i disa mënyrave të paraqitjes vizuale	Rekomandohet që një disenjo industriale duhet të paraqitet duke përdorur vetëm një format vizual (vizatim, fotografi) në mënyrë që të shmanget zbulimi i aspekteve që kontribuojnë në një përshtypje të përgjithshme të ndryshme. Aty ku përdoren paraqitje të shumta të një disenjoje industriale, secili duhet të lidhet qartë dhe në mënyrë të dukshme me të njëjtin disenjo industriale dhe të jetë konsistent kur krahasohen karakteristikat e zbuluara.     CP6 Shembull (21.01) (Automjete [lodra])
--	--

2.3 NË LIDHJE ME SFONDIN NEUTRAL

	Për të vlerësuar nëse një sfond është neutral, duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme:
a) Kërkesat që lidhen me ngjyrat	- Një ngjyrë e vetme ose mbizotëruese në një sfond është gjithmonë e pranueshme nëse dallohet nga ngjyrat e disenjos industriale. - Ngjyra me gradiencë dhe më shumë se një ngjyrë në një sfond është e pranueshme nëse disenjoja industriale është qartësisht e dallueshme   Disenjo industriale austriake me intervale Nr. 1747/1999 (01.01) (Lëpirëse akulli) Pronari: Schöller Lebensmittel GMBH & O. KG   Disenjo Industriale franceze e regjistruar Nr. 955805-0005 (09.07) (Kapak për shishe parfumi) Pronari: SNIC SARL   CP6 Shembull (01.01) (Kekë)

b) Kërkesat që lidhen me kontrastin	- Të gjitha karakteristikat e disenjos industriale duhet të jenë qartësisht të dukshme. - Kontrasti konsiderohet i pamjaftueshëm kur ngjyra e sfondit dhe disenjos industriale janë të ngjashme dhe pjesërisht shkrihen në njëra-tjetrën (pra, nuk është e qartë se ku përfundon produkti dhe fillon sfondi). - Ndonjëherë një sfond i errët mund të ndihmojë kur diseno industriale është e qartë ose e zbehtë dhe anasjelltas.  Diseno industriale BX e regjistruar Nr. 38895-00 (25.03) (Depo) Pronari: Herman Lankwarden  Diseno industriale portugeze me intervale Nr. 420-0006 (06.01) (karrige) Pronari: Abril Mobiliário
c) Kërkesat që lidhen me hijet/reflektimet	- Hijet ose reflektimet janë të pranueshme për sa kohë që të gjitha karakteristikat e disenjos industriale mbeten të dukshme. - Hijet ose reflektimet janë të papranueshme kur subjekti i mbrojtjes i disenjos industriale, në cilëndo nga pamjet e paraqitura, nuk mund të përcaktohet në mënyrë të qartë. Kjo mund të ndodhë kur ka një kontrast të kufizuar ngjyrash me disenjon industriale, dhe/ose hijet ndërhyjnë, ose fshehin pjesë të disenjos industriale ose ato shtrembërojnë konturin e disenjos industriale.  Diseno industriale daneze e regjistruar Nr. 2013 00069 (12.11) (biçikletë transporti me rrota) Pronari: 3PART A/S  CP6 Shembull (11.02) (Vazo me lule)

A close-up photograph of three hands assembling white puzzle pieces. The hands are positioned to fit the pieces together, with one hand holding a piece from above and two others from below. The background is blurred, showing a wooden surface and some tools.

Praktika

Paraqitja grafike e disenjove industriale

Përmbajtja

1.	HYRJE.....	1
2.	PRAKTIKA.....	1
2.1	PËRDORIMI I MOHIMEVE VIZUALE	2
2.1.1	Përkufizimet.....	3
2.1.2	Kërkesat e përgjithshme	4
2.1.3	Rekomandime të përgjithshme.....	5
2.1.4	Udhëzime për llojet e mohimeve vizuale.....	6
2.2	LLOJET E PAMJEVE	11
2.2.1	Përkufizimi i pamjes	12
2.2.2	Format/mjetet e paraqitjes.....	12
2.2.3	Rekomandime të përgjithshme për të gjitha llojet e pamjeve.....	12
2.2.4	Udhëzime për secilën lloj pamjeje.....	13
2.3	SFONDI NEUTRAL	25
2.4	FORMATI I PAMJEVE	31

1. HYRJE

Ky dokument do të jetë referencë për Shoqatat e Përdoruesve, aplikantët dhe përfaqësuesit mbi praktikën e kërkesave për paraqitjen grafike të disenjove industriale.

Këto kërkesa mbulojnë përdorimin e përjashtimeve vizuale nga mbrojtja, përdorimin e llojeve të ndryshme të pamjeve dhe mënyrën e riprodhimit të një disenjoje industriale me një sfond neutral. Për më tepër, ky dokument gjithashtu ofron rekomandime për të rritur kuptimin e aplikantëve se si të riprodhojnë më mirë disenjt industrial të tyre dhe standardet e cilësisë së Zyrës për aplikimet për disenjt industrial të marra me mjete elektronike dhe me letër.

Udhëzimi i mëposhtëm lidhet vetëm me procedurat e ekzaminimit dhe nuk ka për qëllim të japë këshilla mbi objektivin e mbrojtjes së një disenjoje industriale sipas ligjit kombëtar.

Çështjet e mëposhtme janë jashtë objektivit:

- Përjashtimet verbale nga mbrojtja
- Elementet shitesë
- Prioriteti
- Zbulimi i informacionit
- Numri i pamjeve
- Paraqitjet e animuara me kompjuter, paraqitjet 3D

2. PRAKTIKA

Ky seksion përfshin tekstin e plotë dhe të gjithë shembujt e përdorur për të ilustruar parimet e Praktikës. Ai është i ndarë në katër nën-seksione:

- **Përdorimi i përjashtimit vizual nga mbrojtja** – që i adresohen përdorimit të përjashtimit vizual nga mbrojtja si mjet për të treguar karakteristikat për të cilat nuk kërkohet mbrojtje.
- **Llojet e pamjeve** – që u adresohen llojeve të pamjeve që mund të pranohen dhe kërkesat që duhet të përcaktohen për të paraqitur saktësisht disenjt industrial në një aplikim për regjistrim. Ai gjithashtu përcakton nëse një kombinim i fotografive dhe vizatimeve lejohet në paraqitjen e një disenjoje industriale.
- **Sfondi neutral:** përcaktimi i kërkesave për të përcaktuar kur një sfond konsiderohet neutral.
- **Formati i pamjeve:** që zhvillon rekomandimet për paraqitjen e disenjove industriale të

depozituara në formën e vizatimeve dhe/ose fotografive.

2.1 PËRDORIMI I PËRJASHTIMIT VIZUAL NGA MBROJTJA

Pavarësisht pranimi të përjashtimit vizual nga mbrojtja në një aplikim për regjistrimin e një diseno industriale, kjo praktikë është përcaktuar për të siguruar qartësi në rregullat/kërkesat në lidhje me përjashtimin nga mbrojtja, në mënyrë që t'i ndihmojë aplikantët të shpalosin disenjat industriale të tyre në mënyrë korrekte.

Për shkak të rëndësisë së shpalosjes së duhur të disenjos industriale për përcaktimin e fushës së mbrojtjes, në këtë seksion mbi përjashtimin vizual nga mbrojtja përfshihen:

- Përkufizimi i një disenoje industriale dhe përcaktimi i i përjashtimeve vizuale nga mbrojtja.
- Kërkesat e përgjithshme për pranueshmërinë e përjashtimeve vizuale nga mbrojtja.
- Rekomandimet e përgjithshme që ofrohen për të gjitha llojet e përjashtimeve vizuale nga mbrojtja që kanë të bëjë me këtë dokument.
- Udhëzime për çdo lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja. Këto përfshijnë:
 - Një përkufizim të secilit lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja
 - Kërkesat për pranimin e secilit lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja
 - Shembuj

Struktura e propozuar mund të shihet në grafikun e mëposhtëm:




Figura 1 - Struktura e seksionit të përjashtimeve vizuale nga mbrojtja

2.1.1 Përkufizimet

a) Përkufizimi i një disenoje industriale: një “disenjo industriale”, nënkupton karakteristikat e formës së jashtme të një produkti, në përgjithësi, aspekti ornamental ose estetik i një produkti, si një i tërë ose i pjesëve të tij, që i jep atij një pamje të veçantë dhe që nuk përjashtohet nga mbrojtja, sipas pikës 3 të këtij neni— Shkronja (a) e pikës 1, të Nenit 112, të Ligjit Nr. 9447, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar.




b) Përkufizimi i përjashtimit vizual nga mbrojtja: përjashtimet vizuale nga mbrojtja tregojnë se nuk kërkohet mbrojtja dhe se nuk është dhënë regjistrimi për karakteristika të caktuara të disenjos industriale të treguar në paraqitje. Kështu, ato tregojnë atë që nuk synohet të mbrohet. Kjo mund të arrihet:

- Duke përjashtuar me vija të ndërprera, sfumim ose hijezim me ngjyra karakteristikat e disenjos industriale për të cilat nuk kërkohet mbrojtje ose
- Duke përfshirë brenda një bordure karakteristikat e disenjos industriale për të cilin kërkohet mbrojtje, duke e bërë të qartë se nuk kërkohet mbrojtje për çka del jashtë bordurës.



2.1.2 Kërkesat e përgjithshme

Më poshtë janë kërkesat e përgjithshme që duhet të përmbushen nga të gjitha llojet e përjashtimeve vizuale nga mbrojtja:

- Përjashtimet vizuale nga mbrojtja do të pranohen vetëm kur ato tregojnë qartë se nuk kërkohet mbrojtja për karakteristika të caktuara të disenjos industriale të shfaqur në paraqitje.
- Që të pranohet, kur diseno industriale paraqitet në më shumë se një pamje, përjashtimi vizual nga mbrojtja duhet të tregohet në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha pamjet ku shfaqet përjashtimi nga mbrojtja. Për shembull:



RCD Nr. 001282545-0001 (12.06) (Mjete uji)
Pronari: Bombardier Recreational Products Inc.




RCD Nr. 002322644-0001 (07.02) (Doreza
tiganësh)
Pronari: ACTERVIS, GMBH

Shembulli 1 - Përdorimi i vazhdueshëm i përjashtimeve vizuale nga mbrojtja

2.1.3 Rekomandime të përgjithshme

Rekomandimet e përgjithshme të mëposhtme synojnë t'i ndihmojnë aplikantët të paraqesin saktë disenjot industriale të tyre duke përdorur përjashtimet nga mbrojtja. Këto rekomandime janë të zbatueshme për të gjitha llojet e përjashtimeve nga mbrojtja:

- a) Preferohen paraqitjet grafike ose fotografike që tregojnë vetëm disenjon industriale të pretenduar.
- b) Sidoqoftë, për të kuptuar karakteristikat e disenjos industriale për të cilin kërkohet mbrojtje, mund të jetë e dobishme të shfaqet disenjoja industriale në kontekst. Në raste të tilla mund të jetë i nevojshëm përdorimi i përjashtimeve vizuale nga mbrojtja.
- c) Përdorimi i duhur:
 - Përjashtimi vizual nga mbrojtja duhet të jetë i qartë dhe i dukshëm nga paraqitja e disenjos industriale. Duhet të ketë një dallim të qartë midis karakteristikave të pretenduara dhe atyre të përjashtuara nga mbrojtja.



RCD Nr. 150297-0001 (02.04) (Pjesë këpuce) Pronari: Salomon SAS



Regjistrim ndërkombëtar Nr. DM/078504 (12.08) (Automjete) Pronari: DAIMLER AG

Shembulli 2 - Dallimi i qartë midis karakteristikave të pretenduara dhe të përjashtuara nga mbrojtja


- Përjashtimi vizual nga mbrojtja duhet të jetë vetëshpjegues kur vlerësohet në kontekstin e të gjithë disenjos industriale.
- Kur paraqitjet e disenjos industriale janë vizatime me vija, ne rekomandojmë përdorimin e vijave të ndërprera si përjashtime vizuale nga mbrojtja.
- Sidoqoftë, në rastet kur vijat e ndërprera nuk mund të përdoren për arsye teknike (p.sh. kur vijat e ndërprera përdoren për të treguar tegelat e veshjeve ose motiveve; ose përdoren fotografi), rekomandohet përdorimi i sfumimit, hijezimit me ngjyra ose bordurave.

d) Licencat për t'u përdorur

Rekomandohet që përjashtimet vizuale nga mbrojtja të përdoren në ato raste ku paraqitja grafike ose fotografike e disenjës industriale përmban pjesë të produktit për të cilat nuk kërkohet mbrojtje.



RCD Nr. 002182238-0002 (26.03) (Ndriçim i jashtëm) Pronari: Stanislaw Rosa trading as Zakład Produkcji Sprzętu Oświetleniowego ROSA



Dizenjo industriale komunitareme intervale Nr. 000030606-0003 (14.03) (Vendosja e butonit të çelësit për celularë) Pronari: Nokia Corporation

Shembulli 3 - Pamje të dobishme për të treguar kontekstin


2.1.4 Udhëzime për llojet e e përjashtimeve vizuale nga mbrojtja

a) Vijat e ndërprera


Përkufizimi: Vijat e ndërprera përbëhen nga një gjurmë e përbërë nga pika ose vija (ose një kombinim i të dyjave) dhe përdoren për të treguar se nuk kërkohet mbrojtje për karakteristikat që shfaqen duke përdorur një gjurmë të ndërprerë.

Një përjashtim vizual nga mbrojtja i përbërë nga vija të ndërprera zakonisht do të kombinohet me vija të vazhdueshme.


Kërkesat: Për t'u pranuar, karakteristikat për të cilat nuk kërkohet mbrojtje duhet të tregohen qartë me vija të ndërprera, ndërsa pjesët për të cilat kërkohet mbrojtje duhet të tregohen me vija të vazhdueshme.



Dizenjo industriale BX e regjistruar Nr. 38212-0001 (12.16) (Pasqyra të pasme) Pronari: Interimage BV




Dizenjo industriale daneze e regjistruar Nr. 2013 00070 (20.02) (Pjesë të pajisjes për magazinim, afishim, pozicionim dhe shpërndarje të mallrave) Pronari: Brynild Gruppen AS



Disenjo industriale hungareze e regjistruar Nr. D9900409-0001 (08.04)
(Dorezë kaçavide) Pronari: Cooper Industries, Inc.

Shembulli 4 - Vijat e ndërprera


Shënim: Në rastet kur vijat e ndërprera janë një karakteristikë e disenjos industriale (të tilla si tegelat në veshje), kjo duhet të jetë e qartë nga paraqitja. Në raste të tilla, mund të jetë e dobishme të depozitoni, për shembull, një pamje të zmadhuar.



Disenjo industriale franceze e regjistruar Nr.911104-0021 (02.02) (Një xhep
që mban një qese urine) Pronari: MULLIEZ FRERES SA SOCIETE
INDUSTRIELLE

Shembulli 5 - Vijat e ndërprera si karakteristikë e disenjos industriale (si p.sh. tegela në veshje)

Shënim: Në rastet kur vijat e ndërprera janë një karakteristikë e disenjos industriale dhe një pjesë e disenjos industriale duhet të përjashtohet nga mbrojtja, kjo mund të bëhet duke përdorur cilindro nga përjashtimet e tjera vizuale nga mbrojtja, të tilla si hijezimi me ngjyra, sfumimi ose bordurat.




Dizajn francez i regjistruar No.911104-0021 (02.02) (Një xhep që mban një qese urine) Zotëruesi: MULLIEZ FRERES SA SOCIETE INDUSTRIELLE

Shembulli 6 - Përdorimi i përjashtimeve të tjera nga mbrojtja kur vijat e ndërprera janë një karakteristikë e disenjos industriale (si p.sh. tegela në veshje)

b) Sfumimi

Përkufizimi: Sfumimi është një lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja që konsiston në sfumimin e karakteristikave për të cilat nuk kërkohet mbrojtja në vizatimet ose fotografitë e një aplikimi të një disenoje industriale.

Kërkesat: Sfumimi mund të pranohet vetëm kur karakteristikat për të cilat kërkohet mbrojtje dallohen qartë nga karakteristikat e përjashtuara nga mbrojtja (të sfumuara).



RCD Nr. 000244520-0002 (12.15) (Goma për rrota automjetesh, pneumatike)
Pronari: Nokian Tyres plc

Shembulli 7 - Sfumim i aplikuar saktë

c) Hijezimi me ngjyra

Përkufizimi: Hijezimi me ngjyra është një lloj përjashtimi vizual që konsiston në kontrastimin e toneve të ngjyrave për të errësuar mjaftueshëm veçoritë për të cilat nuk kërkohet mbrojtja në vizatimet ose

fotografitë e një aplikimi dizajni.

Kërkesat: Me hijezimin me ngjyra, karakteristikat për të cilat kërkohet mbrojtja duhet të tregohen qartë në mënyrë që ato të jenë qartësisht të perceptueshme, ndërsa karakteristikat e mohuara duhet të paraqiten me një tonalitet të ndryshëm ngjyre dhe në mënyrë të tillë që ato të shfaqen të turbulluara ose të paperceptueshme.



RCD Nr. 000910146-0004 (12.08) (Pjesë automobili)
Pronari: TOYOTA MOTOR CORPORATION

Shembulli 8 - Hijezimi me ngjyra i aplikuar saktë

d) Bordurat

Përkufizimi: Bordurat janë një lloj përjashtimi vizual nga mbrojtja të përdorura në vizatimet ose fotografitë e një aplikimi të një disenjoje industriale për të treguar se nuk kërkohet mbrojtje për karakteristikat që nuk përmbahen brenda bordurës.



RCD Nr. 002182238-0002 (26.03) (Ndriçim i jashtëm) Pronari: Stanisław Rosa trading as Zakład
Produkcji Sprzętu Oświetleniowego ROSA



RCD Nr. 001873688-0003 (02.04) (Shuall këpuce)
Pronari: Mjartan s.r.o.

Shembulli 9 - Bordurat e aplikuara saktë

Kërkesat: Në mënyrë që të pranohen, karakteristikat për të cilat kërkohet mbrojtje duhet të tregohen/paraqiten qartë brenda bordurës, ndërsa të gjitha karakteristikat jashtë bordurës konsiderohen të jenë të përjashtuara nga mbrojtja dhe për këtë arsye nuk mbrohen.

Këshillë: Bordurat duhet të përdoren me kujdes në vizatimet/fotografitë për shkak të rrezikut për të

përfshirë më shumë se vetëm disenjon industriale brenda bordurës. Për shembull:



CP6 Shembull (12.16)
(Grila për hyrjen e ajrit për
automjete)



CP6 Shembull (14.01)
(Krahu i tonit te platformat rrotulluese)

Shembulli 10 - Bordurat e aplikuara gabim

2.2 LLOJET E PAMJEVE

Aplikanti duhet të depozitojë llojet e pamjeve të konsideruara të përshtatshme për një shpalosje të qartë, të plotë dhe të detajuar të disenjës industriale. Nëse të gjitha karakteristikat e disenjës industriale nuk mund të paraqiten në një pamje të vetme, aplikanti mund të dërgojë pamje shitesë që janë të nevojshme për këtë qëllim, subjekt i numrit maksimal të shtatë pamjeve që lejohen nga Zyra.

Informacioni i mëposhtëm synon t'i ndihmojë aplikantët të paraqesin një aplikim të një disenjeje industriale në mënyrë korrekte me llojin e duhur të pamjes, duke lehtësuar njëkohësisht punën e ekzaminuesve të disenjave industriale. Ky seksion mbi llojet e pamjeve përmban sa vijon:

- Përkufizimi i një pamjeje.
- Një përshkrim i formave/mjeteve të mundshme në dispozicion të aplikantëve për të paraqitur disenjot industriale të tyre.
- Rekomandimet e përgjithshme që ofrohen për të gjitha llojet e pamjeve që kanë të bëjë me këtë dokument; dhe
- Udhëzime për secilën lloj pamjeje. Këto përfshijnë:
 - Një përkufizim i secilës lloj pamjeje.
 - Kërkesat për pranimin e secilës lloj pamjeje.
 - Rekomandime për regjistrimin e secilës lloj pamjeje (nëse ka).
 - Shembuj.

Struktura e propozuar mund të shihet në grafikun e mëposhtëm:




Figura 2 - Struktura e seksionit të llojeve të pamjeve

2.2.1 Përkufizimi i pamjes

Një pamje është një paraqitje vizuale e disenjos industriale. Ajo mund të paraqesë disenjon industriale nga drejtime (kënde) të ndryshme ose në momente të ndryshme në kohë ose në gjendje të ndryshme.

2.2.2 Format/mjetet e paraqitjes

Paraqitja e disenjos industriale mund të depozitohet në formën e:

- a) Vizatimeve.
- b) Fotografive.
- c) Çdo mjet tjetër i paraqitjes vizuale i pranuar nga Zyra.

2.2.3 Rekomandime të përgjithshme për të gjitha llojet e pamjeve

Rekomandimet e përgjithshme të mëposhtme synojnë t'i ndihmojnë aplikantët të paraqesin saktë disenjon industriale të tyre duke përdorur llojet e pamjeve. Këto rekomandime janë të zbatueshme për të gjitha llojet e pamjeve:

- a) Është përgjegjësi e aplikantit t'i zbulojë karakteristikat e disenjos industriale në mënyrë sa më të plotë që të jetë e mundur. Kjo ka shumë të ngjarë të arrihet duke përdorur pamjet e aspekteve të disenjos industriale. Sidoqoftë, aplikanti mund të japë pamje plotësuese/shtesë në mënyrë që të zbulojë më tej karakteristikat e disenjos industriale.
- b) Nuk është e detyrueshme që aplikanti të paraqesë një numër të caktuar pamjesh ose një lloj pamjeje të caktuar, për sa kohë që të gjitha karakteristikat e disenjos industriale mund të

perceptohen qartë, nga paraqitjet e dërguara, p.sh. një pamje mund të jetë e mjaftueshme:



RCD Nr. 002324756-0001 (06.01) (Mobilier për ulje) Pronari: Axmann Investment GmbH



RCD Nr. 002327015-0001 (12.11) (Skelet biçiklete) Pronari: Marcin, Kacper Hajek

Shembulli 11 - Pamja e mjaftueshme

- c) Pamjet duhet t'i përkasin të njëjtit disenejoje industriale.
- d) Aplikantët mund të depozitojnë një ose më shumë pamje të disenjos industriale. Çdo pamje duhet të tregohet veçmas.
- e) Në rastin e produkteve të përbëra nga disa pjesë, të paktën një pamje duhet të paraqesë të gjithë produktin.

2.2.4 Udhëzime për secilën lloj pamjeje

Projekti trajton llojet e mëposhtme të pamjeve:


- a) Pamjet e aspekteve.
- b) Pamjet që zmadhojnë pjesë të disenjos industriale.
- c) Pozicionet alternative.
- d) Pamjet e çmontuara.
- e) Pamjet e pjesshme.
- f) Pamjet e prerjeve të tërthorta.
- g) Sekuencën e fotografive.
- h) Kombinimin e disa mjeteve të paraqitjes vizuale.

a) Pamjet e aspekteve

Përkufizimi: Pamjet e aspekteve tregojnë disenjon industriale nga drejtime (kënde) të caktuara dhe përfshijnë pamjet e mëposhtme: pamjen e përparme, pamjen e sipërme, pamjen e poshtme, pamjen e anës së djathtë, pamjen e anës së majtë, pamjen e pasme dhe pamjet në perspektivë.



RCD Nr. 002325456-0001 (31.00) (Mikserë, elektrikë [kuzhinë])
Pronari: KENWOOD LIMITED



Shembulli 12 - Pamjet e aspekteve

Rekomandimet: Rekomandohet që aplikanti të depozitojë sa më shumë skedarë që të jetë e nevojshme shtesë në mënyrë që të zbulojë plotësisht karakteristikat e disenjos industriale, në varësi të numrit maksimal të pamjeve të lejuara nga secila Zyrë. Në disa raste një pamje mund të jetë e mjaftueshme.



RCD Nr. 002319392-0001 (25.04) (Shkallë stolash)
Pronari: CDH GROUP (société par actions simplifiée)



RCD Nr. 002327015-0001 (12.11) (Skelet biçiklete)
Pronari: Marcin, Kacper Hajek



Shembulli 13 - Pamja e mjaftueshme

b) Pamje që zmadhojnë një pjesë të disenjos industriale

Përkufizimi: Pamjet e zmadhuara tregojnë një pjesë të disenjos industriale të përgjithshme në një shkallë të zgjeruar.

Kërkesat:

- Një pamje e vetme e zmadhuar është e pranueshme me kusht që pjesa e zmadhuar të jetë tashmë e dukshme në njërin nga pamjet e tjera të paraqitura.
- Pamja e cila tregon pjesën e zmadhuar të disenjos industriale duhet të paraqitet në një pamje të veçantë të vetme.



RCD No. 001913690-0002 (24.02) (Pllaka PCR me shumë fole) Zotëruesi: ABGENE LIMITED



CP6 Shembull (32.00) (Motivet e sipërfaqes)



c) Pozicionet alternative

Përkufizimi: Disenjat industriale me pozicione alternative kanë një pamje e cila mund të modifikohet në disa konfigurime pa ndonjë pjesë shtesë ose heqje të ndonjë pjese.


Këto disenjo industriale kanë faza të paracaktuara përdorimi i të cilave i përgjigjet një pozicioni alternativ. Në disa raste konfigurime të ndryshme mund të rezultojnë në produkte të ndryshme si në rastin e një çante e cila kthehet në peshqir (shih shembullin 16).

Kërkesat:

- Pamjet që tregojnë konfigurimet e ndryshme të disenjos industriale janë të pranueshme me kusht që asnjë pjesë të mos shtohet ose hiqet.
- Pamjet që tregojnë konfigurimet e ndryshme të disenjos industriale duhet të tregohen veçmas.



RCD Nr. 002257493-0001 (25.02) (Ndërtim çatie)
Pronari: Glazing Vision Ltd.



RCD Nr. 000588694-0012 (14.03) (Telefona celulare)
Pronari: Fujitsu Mobile Communications Limited



RCD Nr. 002319814-0001 (06.06) (Mobilier argëtimi)
 Pronari: Przedsiębiorstwo Wielobranżowe KAREX Krzysztof Karpiński




RCD Nr. 002329938-0001 (06.01) (Karrige [ndenjësë]) Pronari: Stechert Stahlrohrmöbel GmbH




RCD Nr. 002329938-0001 (06.01) (Karrige [ndenjësë]) Pronari: Stechert Stahlrohrmöbel GmbH

Shembulli 16 - Pozicione alternative të pranueshme (pamje të ndryshme)



RCD Nr. 002257493-0001 (25.02) (Ndërtimë çatie)
Pronari: Glazing Vision Ltd.



RCD Nr. 000588694-0012 (14.03) (Telefona celularë)
Pronari: Fujitsu Mobile Communications Limited

Shembulli 17 - Pozicione alternative të papranueshme (fazat e paracaktuara të përdorimit të disenjës industriale tregohen në të njëjtën pamje)


d) Pamjet e çmontuara

Përkufizimi: Pamjet e çmontuara përbëhen nga pamje ku pjesët e një produkti shfaqen të çmontuara për të sqaruar se si pjesët përshtaten së bashku.


Kërkesat:

- Pamjet e çmontuara duhet të kombinohen me të paktën një pamje që paraqet produktin e montuar (shiko shembullin 18 - pamja nr.2 e kombinuar me pamjen nr.1).
- Në këto pamje, të gjitha pjesët e një produkti duhet të tregohen të çmontuara në një pamje të veçantë të vetme (shiko shembullin 18 - pamja nr.2).
- Pjesët e çmontuara duhet të tregohen në afërsi dhe sipas rendit të montimit (shiko shembullin 18 - pamja nr.2).



Shiko nr. 1 E montuar



**Shiko nr. 2 E
çmontuar**





RCD Nr. 001847468-0003 (09.03) (Paketim)
Pronari: Josefa Colls Llobet



Shembulli 18 - Pamjet e çmontuara

Diseno industriale kroate e regjistruar Nr. D20140080 (24.01)
(Byzylykë me stimulues për muskujt) Pronari: Dominik Žinić



RCD 001385926-0001 (09.03) (Enë pijesh)
Pronari: Mocktail Beverages, Inc.

Shënim: Shfaqja e pjesëve të çmontuara në një pamje shtesë mund të ndihmojë në lehtësimin e të kuptuarit të disenjos industriale. Sidoqoftë, përshtatshmëria e përdorimit të pamjeve të çmontuara për të paraqitur disenjon industriale nuk paragjykon kufizimet e parashikuara nga ligji kombëtar ose evropian në lidhje me mbrojtjen e pjesëve të padukshme ose pjesërisht të dukshme të një produkti kur është në përdorim.

e) Pamjet e pjesshme (pamjet fragmentare)

Përkufizimi: Një pamje e pjesshme është një pamje që tregon një pjesë të një produkti të izoluar. Një pamje e pjesshme mund të zmadhohet.

Kërkesat:

- Pamjet e pjesshme duhet të kombinohen me të paktën një pamje që përfaqëson produktin e montuar (pjesët e ndryshme duhet të lidhen me njëra -tjetrën) - shiko shembullin 19, pamjet nr.2, 3 dhe 4 të kombinuara me pamjen nr.1.

Pamje e montuar nr. 1



Pamje e pjesshme nr. 2



Pamje e pjesshme nr. 3



Pamje e pjesshme nr. 4





Shembulli 19 - Pamjet e pjesshme

f) Pamjet e prerjeve të tërthorta



Përkufizimi: Pamjet e prerjeve të tërthorta janë pjesë të prera që plotësojnë pamjet e aspektit duke ilustruar një karakteristikë ose karakteristika të paraqitjes së produktit, siç është konturi, sipërfaqja, forma ose konfigurimi i produktit.

Kërkesat:

- Paraqitjet me indikacione teknike, të tilla si linjat aksiale ose madhësitë (dimensionet), numrat etj. nuk janë të pranueshme.
- Pamja e prerjes së tërthortë duhet, në mënyrë të qartë, të jetë një pamje e të njëjtit diseno industriale.
- Pamjet e prerjeve të tërthorta nuk duhet të paraqiten pa pamje të tjera tradicionale siç janë pamjet e aspekteve.



Diseno industriale spanjolle e regjistruar Nr. I0152702-D (01.01) (Biskota) Pronari: CUETARA, S.L.



Shembulli 20 - Pamjet e prerjeve të tërthorta


Shënim: Shtimi i pamjeve të prerjeve të tërthorta mund të ndihmojë në lehtësimin e të kuptuarit të disenjos industriale. Sidoqoftë, përshtatshmëria e përdorimit të këtyre pamjeve për të paraqitur disenjon industriale nuk paragjykon kufizimet e parashikuara nga ligji kombëtar ose evropian në lidhje

me mbrojtjen e pjesëve të padukshme ose pjesërisht të dukshme të një produkti kur është në përdorim.


g) Sekuencë pamjesh të shkrepura (dizenjo industriale e animuar)

Përkufizimi: Pamjet e shkrepura janë një sekuencë e shkurtër e pamjeve të përdorura për të treguar një dizeno industriale të vetme të animuar në momente të ndryshme specifike në kohë, në një progres të qartë dhe të kuptueshëm. Kjo vlen për:

- Një ikonë të animuar (dizenjo industriale që përbëhet nga një sekuencë)





RCD Nr 2085894-0014 (14.04) (Pamje ekrani të animuara) Pronari: NIKE Innovate C.V.



RCD Nr 001068001-0002 (14.04) (Ikona, Ikona të animuara, Pamje ekrani dhe ikona) Pronari: Deutsche Telekom AG

- Një ndërfaqe grafike e animuar e përdoruesit (dizenjo industriale e një ndërfaqeje).





RCD Nr 001282388-0031 (14.04) (Ndërfaqe grafike të animuara përdoruesi për një pamje ekrani ose pjesë të tij)
Pronari: Sony Corporation

Kërkesat:


- Në parim, të gjitha pamjet e një ikone të animuar dhe ndërfaqes grafike të përdoruesit duhet të jenë të lidhura vizualisht, kjo do të thotë se ato duhet të kenë karakteristika të përbashkëta.
- Është përgjegjësi e aplikantit t'u vendosë numra pamjeve në mënyrë të tillë që të japë një perceptim të qartë të lëvizjes/progresionit.

Shënim: Një videoklip është një mënyrë e mundshme për të paraqitur diseno industriale të tilla (pasi lejon që sekuenca e lëvizjes të shihet dhe vlerësohet vizualisht), megjithëse mjetet teknike për të paraqitur një diseno industriale duke paraqitur një videoklip nuk janë ende në dispozicion.

h) Kombinimi i disa mjeteve të paraqitjes vizuale

Këshillë

Një diseno industriale duhet të paraqitet duke përdorur vetëm një format vizual (vizatim ose fotografi) në mënyrë që të shmangët zbulimi i aspekteve që kontribuojnë në një përshtypje të ndryshme të përgjithshme. Aty ku përdoren paraqitje të shumta të një disenjoje industriale, secili duhet të lidhet qartë dhe në mënyrë të dukshme me të njëjtin diseno industriale dhe të jetë konsistent kur krahasohen karakteristikat e zbuluara.



CP6 Shembull (21.01) (Automjete [lodra])

Shembulli 23 - Kombinim i papranueshëm

2.3 SFONDI NEUTRAL

Edhe pse Zyra kërkon që aplikimet e disenjos industriale të paraqiten në një sfond neutral, nevojitet të sqarohet nocioni i sfondit neutral.

Prandaj, për të vlerësuar nëse një sfond është neutral, duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme: ngjyrat, kontrasti dhe hijet.





Figura 3 - Struktura e seksionit të sfondit neutral

2.3.1 Kërkesat që lidhen me sfondin me ngjyrë

- a) Një ngjyrë e vetme ose mbizotëruese në një sfond është gjithmonë e pranueshme nëse dallohet nga ngjyrat e disenjos industriale.



Disenjo industriale austriake me intervale
Nr. 1747/1999 (01.01) (Lëpirëse akulli)
Pronari: Schöller Lebensmittel GMBH &
O. KG




RCD Nr. 001390298-0001 (15.05) (Pjesë
lavatriceje)
Pronari: BSH Hausgeräte GmbH

Shembulli 24 - Sfond i pranueshëm me një ngjyrë



CP6 Shembull (09.02) (Bidonë metalikë)




CP6 Shembull (22.05) (Karrem për
peshkim)

Shembulli 25 - Sfond i papranueshëm me një ngjyrë



RCD Nr. 002333484-0001
(02.02) (Veshje sportive) Pronari: La Hoya
Lorca - Club de fútbol



Disenjo industriale greke me intervale No.
20040600136-0001 (11.01) (Byzylyk)
Pronari: Maria Mantzagrioti Meimaridi

Shembulli 26 - Sfond i pranueshëm me ngjyrë mbizotëruese



CP6 Shembull (01.01) (Kekë)

Shembulli 27 - Sfond i papranueshëm me ngjyrë mbizotëruese


- b) Ngjyra me gradiencë dhe më shumë se një ngjyrë në një sfond është e pranueshme nëse diseno industriale është qartësisht e dallueshme.



Diseno industriale daneze e regjistruar Nr. 2013 00008 (23.01) (Rubineta) Pronari: Line Nymann, Emilie Kampmann, Nadja Ibsen, Pernille Hinborg



RCD Nr. 001387476-0001 (09.01) (Shishe) Pronari: Vandemoortele Lipids, naamloze vennootschap



Diseno industriale franceze e regjistruar Nr. 955805-0005 (09.07) (Kapak për shishe parfumi) Pronari: SNIC SARL

Shembulli 28 - Gradienca e pranueshme/më shumë se një sfond me ngjyrë


2.3.2 Kërkesat që lidhen me kontrastin

- a) Të gjitha karakteristikat e disenjës industriale duhet të jenë qartësisht të dukshme.
- b) Kontrasti konsiderohet i pamjaftueshëm kur ngjyra e sfondit dhe disenjës industriale janë të ngjashme dhe pjesërisht shkrihen në njëra-tjetrën. Rezultati është se jo të gjitha pjesët e disenjës industriale do të kenë kontrast të mjaftueshëm me sfondin (pra, nuk është e qartë se ku përfundon produkti dhe fillon sfondi).
- c) Ndonjëherë një sfond i errët mund të ndihmojë kur diseno industriale është e qartë ose e zbehtë dhe anasjelltas.



Diseno industriale BX i regjistruar Nr. 38895-00 (25.03) (Depo)
Pronari: Herman Lankwarden

Shembulli 29 - Kontrast i mjaftueshëm



Diseno industriale portugez me
intervale Nr. 420-0006 (06.01)
(Karrige) Pronari: Abril
Mobiliário



CP6 Shembull (06.01)
(Karrige)



RCD Diseno industriale me
intervale Nr. 000234265-0001
(09.01) (Shishe) Pronari:
Torgovy Dom Aroma (ZAO)

Shembulli 30 - Kontrast i pamjaftueshëm

2.3.3 Kërkesat që lidhen me hijet/reflektimet

- a) Hijet ose reflektimet janë të pranueshme për sa kohë që të gjitha karakteristikat e disenjos industriale mbeten të dukshme.
- b) Hijet ose reflektimet janë të papranueshme kur subjekti i mbrojtjes i disenjos industriale, në cilëndo nga pamjet e paraqitura, nuk mund të përcaktohet në mënyrë të qartë.

Kjo mund të ndodhë kur:

- ka një kontrast të kufizuar ngjyrash me disenjon industriale;
- hijet nuk lejojnë vlerësimin e të gjitha karakteristikave të disenjos industriale, për shembull sepse ato ndërhyjnë ose fshehin pjesë të disenjos industriale ose shtrembërojnë konturin e disenjos industriale.



Disenjo industriale daneze e regjistruar
Nr. 2013 00030 (08.05, 08.08)
(Mbajtëse)
Pronari: KITCINO ApS



Disenjo industriale daneze e regjistruar
Nr. 2013 00057 (11.01) (Bizhuteri)
Pronari: House of Hearing



Disenjo industriale daneze e regjistruar
Nr. 2013 00069 (12.11) (Biçikletë
transporti me rrota) Pronari: 3PART
A/S

Shembulli 31 - Hije të pranueshme



CP6 Shembull (11.02) (Vazo me lule)



CP6 Shembull (14.01) (Kufje)

Shembulli 32 - Hije të papranueshme



CP6 Shembull (11.01) (Unaza për gisht)

Shembulli 33 - Reflektime të pranueshme



CP6 Shembull (07.01) (Tasa për fruta)



CP6 Shembull (07.01) (Tasa për fruta)

Shembulli 34 - Reflektime të papranueshme

2.4 FORMATI I PAMJEVE

Standardet e cilësisë të kërkuara për aplikimet e marra me mjete elektronike dhe me letër janë si më poshtë:

Aplikimet e marra në letër	
Paraqitja e disenjës industriale në letër (p.sh. madhësia e fletës së veçantë dhe kërkesat e tjera)	Riprodhimi i disenjës duhet të depozitohet së bashku me aplikimin, duke u ngjitur ose printuar mbi një fletë të bardhë format A4. Mbi këtë fletë nuk duhet të vendosen tekste shpjeguese, shkronja apo simbole, përveç një treguesi që tregon kreun e fletës, kur është e nevojshme. Riprodhimet grafike apo fotografike të disenjës duhet të përfshijnë vetëm pamjen e produktit pa ndonjë objekt tjetër aksesor, person ose kafshë
Numri maksimal i disenjave industriale për aplikim	Dy ose më shumë disenjo mund të bashkohen në një aplikim të vetëm, në përputhje me klasifikimin ndërkombëtar të disenjave industriale (marrëveshja e Lokarnos)
Numri maksimal i pamjeve të paraqitura për disenjon industriale	Paraqitja e disenjës duhet të përmbajë jo më shumë se shtatë pamje të ndryshme të disenjës, njëra prej të cilave duhet të jetë pamja e përgjithshme e saj.
Numri i paraqitjeve që mund të dorëzohen për fletë	Secili prej riprodhimeve grafike ose fotografike të disenjës duhet të përmbajë vetëm një pamje të disenjës.
Secila paraqitje korrespondon me një pamje?	PO.
Dimensionet e paraqitjes në fotografi dhe vizatime në një aplikim të vetëm dhe të shumëfishtë (minimal dhe maksimal)	Madhësia e riprodhimit të disenjës së vendosur mbi fletën e bardhë format A4, duhet të jetë në përmasa jo më të mëdha se 26,2 cm x 17 cm dhe jo më të vogla se 4cm x 4cm.
A tregohet numri i pamjeve?	Aplikanti duhet t'i vendosë secilës prej pamjeve të disenjës një numër rendor. Në rastin e aplikimeve për disenjo të shumëfishta, për secilën pamje duhet të vendoset numri rendor, i cili përbëhet nga numri i disenjës dhe më pas numri i

	pamjes, të ndara mes tyre me një pikë;
A lejohen përshkrimet e llojeve të pamjeve p.sh. pamja e përparme, pamja e pasme?	JO.
Lejohen brenda paraqitjes vizatimet teknike; teksti shpjegues, formulimi ose simbolet?	Nuk duhet të vendosen tekste shpjeguese, shkronja apo simbole, përveç një treguesi që tregon kreun e fletës, kur është e nevojshme.
Numri i kopjeve të kërkuara	Një kopje

Aplikimet e marra elektronikisht	
Numri maksimal i pamjeve për Bashkëngjitje	Vetëm një dokument mund të ngarkohet (uploaded) në formatin PDF, madhësia e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 5 MB.
Numri maksimal i disenjove industriale të ngarkuara për aplikim	Vetëm një dokument mund të ngarkohet (uploaded) në formatin PDF, madhësia e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 5 MB.
Numri maksimal i pamjeve të ngarkuara për diseno industriale	Vetëm një dokument mund të ngarkohet (uploaded) në formatin PDF, madhësia e të cilit nuk duhet të jetë më e madhe se 5 MB
Lloji i Formatit të Skedarit	.pdf
Kufiri Total i Madhësisë së Aplikimit	Të dhënat e aplikimit nuk kanë limit. Dokumentat që mund të ngarkohen në total janë 6, me limit madhësie 5 MB secila.
Kufiri i Madhësisë për Pamje	5 MB
Rezolucioni Minimal dhe Maksimal (dpi)	Nuk ka kontrolle mbi rezolucionin, kontrollohet vetëm madhësia e skedarit. Duhet të jetë jo më shumë se 5MB.
A ka zyra juaj një sistem E-Filing? Nëse po, cilin? Nëse jo, a është	PO, ju mund ta gjeni nëpërmjet këtij linku: https://e-

2.4.1 Rekomandimet e cilësisë për paraqitjen e disenjove industriale të depozituara në formën e vizatimeve dhe/ose fotografive

Për t'i ndihmuar përdoruesit të kuptojnë më mirë se si t'i paraqesin disenjt industrialë të tyre, jepen më poshtë rekomandimet për paraqitjen e disenjove industriale të paraqitura në formën e vizatimeve dhe/ose fotografive.

- a) **Në formën e vizatimeve:** Vizatimet duhet të jenë të një cilësie të mirë në mënyrë që imazhet të vizatohen me vija të qarta dhe të errëta të vazhdueshme. Paraqitjet duhet të jenë në gjendje që të riprodhohen në mënyrë që karakteristikat e disenjos industriale të mbeten qartësisht të dukshme.

Kështu, në paraqitjet duhet të shmangen sa vijon:

- Cilësia e dobët e vijave.
- Vijat e paqarta.
- Pikselizimi i lartë.
- Vijat të cilat bashkohen duke formuar zona të zeza dhe të papërcaktuara.
- Vizatimet të cilat janë tepër të vogla ose të mëdha.
- Vizatimet me shenja fshirjeje ose korrigjimi.

- b) **Në formën e fotografive:** Paraqitjet e disenjos industriale të paraqitura në formën e fotografive duhet të jenë të një cilësie të mirë. Disenjoja industriale duhet të tregohet në mënyrë të tillë që të gjitha karakteristikat e disenjos industriale të shfaqura të jenë qartësisht të dukshme dhe të përshtatshme për riprodhim. Për të garantuar cilësinë e paraqitjes së fotografive, duhet të shmangni sa vijon:

- Zonat e papërcaktuara për shkak të mungesës së ndriçimit.
- Shkëlqimin në sipërfaqe me shkëlqim, reflektuese ose transparente.
- Sfumimi (nëse nuk përdoret si përjashtim nga mbrojtja).
- Kontrastin e dobët.
- Fshirjet ose korrigjimet e dukshme.